



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:020962

Datë: 22.11.2018

Numri i dokumentit: 00174806

P. nr. 901/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe me zyrtaren ligjore Flutur Nagavci , në lëndën penale kundër të akuzuarve Gj.B.nga fsh. B. K Gj. dhe B.K. nga fsh. J.K Gj. , për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti–Përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.1242/17 të dt. 06.12.2017, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me dt.**05.02.2018**, murr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë PP.nr.1242/17 e dt.06,12,2017 dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të akuzuarit:

GJ.B., i biri i Z. dhe i nënës K. e gjinisë N.i , data e lindjes në fsh. B. K Gj., me banim ne Gj.- A. ,ku edhe tani banon, punëtor fizik , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

B.K. , i biri i M. dhe i nënës M. e gjinisë B. , data e lindjes..., në fsh. J. K Gj., ku edhe tani banon ,i gjendjes se mesëm ekonomike , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **Gj.B.** :

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

-Me dt.**18.08.2017**, rreth orës **17.00 min**, në fsh.J. K Gj., i shkakton lëndime te lehta trupor te dëmtuarit B. K. ,në atë mënyrë qe derisa këtu i dëmtuari po e mirëmbante shtëpinë e axhës se tij ,në rrugë ishte ndalur një veture brenda se cilës ndodhej i akuzuari Gj.B. ,ashtu që pasi që del nga vetura fillon konfrontimi verbal në mes tyre dhe për një moment e sulmon

fizikisht duke i shkaktuar krisje te eshtrave te hundës ,veprime këto qe te dëmtuarit i shkakton lëndime te lehta trupore me gjerësisht në ekspertizën mjeko ligjore te dt. 070.4.2017

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari **B. K.:**

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

Se me datë, kohë dhe vendin e njëjtë si në dispozitivin e I-rë te aktakuzës ,i akuzuari B.K. i shkakton lëndime te lehta trupore te dëmtuarit Gj.B. ,në atë mënyrë qe pas një përlshje në mes tyre filluar si ne dispozitivin e I-rë ,i akuzuari B.e godet me grushte në nofullën e poshtme te fytyrës te dëmtuarin ,derisa i njëjti rrëzohet në tokë dhe humb te pamurit ,veprime këto qe te dëmtuarit i shkakton lëndime te lehta trupore ne gjerësisht ne ekspertizën mjeko ligjore te dt. 05.12.2017.

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

Andaj ,Gjykata konform nenit 4,41,43, 46,73 dhe nenit 188 par.1 te KPRK-së ,si dhe nenit 495 te KPPK-se ,të akuzuarit Gj.B. dhe B.K. , i

G J Y K O N

Të akuzuarin **Gj.B.me** dënimin me gjobë në shumë prej **200, 00 € (dyqind euro)**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë , së këtij Aktgjykimi -Urdhër ndëshkimor, në kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

Të akuzuarin **B. K. me** dënimin me gjobë në shumë prej **200, 00 € (dyqind euro)**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë , së këtij Aktgjykimi -Urdhër ndëshkimor, në kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPRK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 49 par.4 të KPPK-së , do t'ju zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10(dhjetë)ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20,00 € (njëzet) euro**.

Të akuzuarit obligohen që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej nga **10.00 euro** në emër të ekspertizës mjeko ligjore si dhe ne emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga **20,00 euro**, e këtë në afat prej **15 ditësh** pasi që Aktgjykimi-urdhri ndëshkimor të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP.nr. 1242/17 të dt. 06.12.2017, ndaj të akuzuarve Gj.B. nga fsh. B. K Gj. dhe B. K. nga fsh. J. K Gj., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së .

Komfor nenit 493 te KPPK-së , PTH në Gjakovë , kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarve të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtëve t'i shqiptohet dënimi me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës së nenit 188 par 1 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesit e kësaj veprë penale parasheh dënim me gjobë apo me burgim gjerë në 1(një) vjet .

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH –se në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarve dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- kallëzimi penal me nr. 2017-EA-940 dt. 18.08.2017,
- deklarata e te dyshuarit Gj. B. ,dhënë në st.policor 18.08.2017,
- deklarata e te dyshuarit B. K. dhënë në st.policor ,18.08.2017
- deklarata e dëshmitarit N. K. dhënë në st.policor ,18.08.2017
- raporti i oficerit të st.policor ,18.08.2017
- ekspertiza mjekoligjore e Dr. N. H. ,mbi natyrën e lëndimeve trupore e dt.05.12.2017

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se të akuzuarit janë kryes të veprës penale për të cilën akuzohen.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPRK-së në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr konform nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.901/17 të dt. 05.02.2018

Sekretarja Juridike :
Flutur Nagavci

Gjyqtarja
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës ,Gjyqtares të kësaj Gjykate. Nëse e pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formën e prerë.